From: Bashkia Sarande (bashkiasarande@yahoo.com)

To: [redacted]

Date: Monday, January 12, 2026 at 09:29 AM GMT+1

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj administruar pranë adresës zyrtare elektronike të Bashkisë Sarandë datë 11.12.2025 , ju informojmë si më poshtë:

1. Lidhur me Buxhetin Vjetor 2024 dhe 2025 të Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, është konsultuar me publikun në zbatim të parashikimeve ligjore të nënit 18 të ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar ku shprehimisht parashikohet se:

1. *Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillonseanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet54, shkronjat"a","dh","e","f"dhe"k",dhe77,shkronjat"a","**dh**","e","f"dhe"k",tëkëtijligji.*

Bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion kopje të njoftimeve të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Sarandë.

2. Lidhur me pyetjen e dytë, ju informojmë se lidhur me të gjitha projekt vendimet për periudhën Janar 2025 – Dhjetor 2025 të cilat janë objekt i parashikimeve për konsultim bazuar në ligjin 139/2015 *Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar , janë publikuar në faqen e internetit të Bashkisë.

3. Për sa i përket Paketës Fiskale të vitit 2024 dhe 2025 të Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, është konsultuar me publikun në zbatim të parashikimeve ligjore të nënit 18 të ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar ku shprehimisht parashikohet se:

1. *Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillonseanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet54, shkronjat"a","dh","e","f"dhe"k",dhe77,shkronjat"a","dh","e","**f**"dhe"k",tëkëtijligji.*

Bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion kopje të njoftimeve të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Sarandë.

4. Për periudhën Janar 2025-Dhjetor 2025 , Bashkia Sarandë nuk ka patur projekt vendim për miratim me objekt tjetërsimin e pronave të paluajtshme të saj.

5. Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2025- Dhjetor 2025 ka publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Sarandë njoftimet për mbledhjet e këshillit , ku janë të pasqyruara ora , data dhe rendi i ditës së mbledhjes.

6. Njoftimet lidhur me mbledhjet e komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2025- Dhjetor 2025 janë pjesë e njoftimit të publikuar për zhvillimin e mbledhjeve për çdo muaj.

7. Bashkëlidhur do të gjeni kopje te njoftimeve.

8. Shuma totale e detyrimeve të prapambetura të bashkisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është [redacted] dhe Janar-Djetor 2025 është [redacted] Vlera që zë procesi i rindërtimit është [redacted]

9. Periudha e shlyerjes është parashikuar të jetë në vitin 2026.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,